

Në bazë të nenit 25 dhe 47 paragrafi 1 pika 20 nga Ligji për Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16 dhe 83/18), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi

VENDIM
PËR EMETIMIN E KARTËMONEDHAVE ME VLERË NOMINALE 500 DENARË ME
KARAKTERISTIKA THEMELORE TË NDYSHUARA

1. Me këtë vendim emetohen kartëmonedha me vlerë nominale 500 denarë me karakteristika themelore të ndryshuara.

2. Kartëmonedhat me vlerë nominale 500 denarë kanë karakteristikat themelore të përshkruara në Vendimin për emetimin e vlerave nominale dhe karakteristikave themelore të kartëmonedhave („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 45/96) dhe Vendimin për emetimin dhe shtypjen e kartëmonedhave me vlerë nominale 500 dhe 1000 denarë me karakteristika themelore të ndryshuara („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ 46/03), me këto ndryshime:

- Në Vendimin për emetimin e vlerave nominale dhe karakteristikave themelore të kartëmonedhave („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 45/96) në nënpikën 2, shkurtesa: „НБРМ“ zëvendësohet me shkurtesën „НБРСМ“.

- Në nënpikën 2 g) në paragrafët 1 dhe 2 fjalët: „Народна банка на Република Македонија“ zëvendësohen me fjalët: „Народна банка на Република Северна Македонија“.

3. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e shpalljes në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut“.

Nr.V. 02-15/II-6/2019
28 shkurt viti 2019
Shkup

Guvernator dhe Kryetar
i Këshillit të Bankës Popullore
të Republikës së Maqedonisë
Dr. Anita Angelovska-Bezhoska, d.v.